

Mr. Rejhan Neziri

**JETA FETARE NË TETOVË DHE
RRETHINË**

(STUDIM SOCIOLOGJIK)

Kreuzlingen

Zvicër, 2003



Xhamia e Larme (e Pashës) në Tetovë, e ndërtuar në shek. XVI

HYRJE

Falënderimi i takon All-llahut xh. sh., Krijuesit të botëve; përshëndetjet qofshin mbi Muhammedin a.s., familjen e tij të ndershme dhe shokët e tij besnikë.

Kjo broshurë përbën njërin kapitull të punimit tim të magjistraturës të titulluar “*JETA SHOQËRORE DHE FETARE NË TETOVË DHE RRETHINË*” të mbrojtur në Universitetin Uludağ të Turqisë në tetor të vitit 2000 nga lënda e Sociologjisë së religjionit. Punimi është një studim monografik për jetën shoqërore dhe fetare në Tetovë dhe rrethinë duke u mbështetur në të dhëna të besueshme lidhur me terrenin në fjalë dhe duke përdorur metoda të mirëfillta shkencore sociologjike. Punimi në fjalë përbëhet prej pesë kapitujve: 1) Pozita gjeografike e Tetovës me rrethinë dhe historia e saj, 2) Jeta familjare, 3) Jeta shoqërore (sociale), 4) Jeta fetare, dhe 5) Jeta ekonomike.

Duke qenë se për momentin nuk ekziston mundësia për botimin e tërësishëm të gjithë këtij punimi, e shoh të arsyeshme që, me disa përshtatje të reja e të domosdoshme, së paku lexuesit t’ia ofroj vetëm njërin kapitull të këtij studimi, pra, atë që ka të bëjë me jetën fetare në Tetovë dhe rrethinë, ku në fillim jepet një përkufizim i përgjithshëm për fenë dhe vështirësitë që hasen gjatë përkufizimit të nocionit fe nga aspekti sociologjik; pastaj shtjellohet religjioziteti (fetarësia) dhe matja e intensitetit të tij në këtë terren; faktorët që ndikojnë në ngritjen dhe shtrirjen e ndjenjave fetare të banorëve të kësaj ane; bestytnitë apo besimet e kota të përhapura ndër popullatën e këtij rrethi...

Qëllimi ynë në këtë punim është që sa më drejtë e sa më realisht ta përshkruajmë jetën fetare në Tetovë e rrethinë e jo të japim ndonjë gjykim vlerësues lidhur me mënyrën se sa drejtë apo sa shtrembër, sa mirë apo sa keq dhe si duhet të aplikohet feja ndër popullatën e këtij vendi.

Mundi prej nesh, kurse rezultati është prej All-llahut xh.sh.!

mr. Rejhan Neziri
Imam në Kreuzlingen, Zvicër
Korrik – 2003

PËRMBAJTJA:

HYRJE	iii
PËRMBAJTJA:.....	iv
JETA FETARE NË TETOVË DHE RRETHINË.....	1
A. PËRGJITHËSISHT PËR FENË.....	1
B. GRUPET FETARE NË TETOVË DHE RRETHINË	2
C. JETA FETARE (RELIGJIOZITETI) NË TETOVË DHE RRETHINË.....	4
D. FAKTORËT QË NDIKOJNË NË JETËN FETARE TË MUSLIMANËVE NË TETOVË ME RRETHINË.....	8
1) Bashkësia Islame – Myftynia e Tetovës.....	8
a) Xhamitë	8
b) Mektebet.....	10
2) Shoqatat e ndryshme fetare dhe aktivitetet e tyre	11
a) Shoqata fetare “MEXHLISI”	11
b) Shoqata fetare “RUMI”	12
c) Shoqata e femrave muslimane “ISLAMI DHE SHKENCA”	12
d) Komuniteti Bektashian në Tetovë.....	13
E. BESTYTNITË NDËR MUSLIMANËT E TETOVËS ME RRETHINË	15
PËRMBYLLJE.....	17
LITERATURA E KONSULTUAR	18

JETA FETARE NË TETOVË DHE RRETHINË

A. PËRGJITHËSISHT PËR FENË

Njëra ndër institucionet kryesore të shoqërisë, krahas familjes, arsimit, ekonomisë, politikës dhe kohës së lirë, gjegjësisht rekreimit, bën pjesë edhe feja bashkë me institucionet ndihmëse të saj siç janë: relacioni hoxhë-xhema'at (klerik-besimtarë), sistemi i duave (lutjeve), ceremonitë fetare etj., e disa këtu i numërojnë edhe magjitë bashkë me bestytnitë.¹

Çështja e përkufizimit të fesë ka shkaktuar diskutime dhe tendenca e me këtë edhe qasje të ndryshme në lëmin e sociologjisë së religjionit e cila kryesisht merret me studimin e ndikimit të ndërsjellë midis fesë dhe shoqërisë duke i përdorur metodat shkencore të sociologjisë së përgjithshme. Meqenëse nuk ekziston vetëm një fe, porse ka më shumë syresh, është vështirë të bësh një përkufizim të përpiktë e të pranueshëm për të gjithë pjesëtarët e këtyre feve. Vetë termi “fe” nuk ngjall të njëjtin asociacion në mendjen e një budisti dhe të një hebreu. I njëjti dallim madje hetohet edhe midis një muslimani e një të krishteri, përkundër mjaft veçorive të përbashkëta të tyre lidhur me fenë. Për një të krishter, i cili qysh në krye të herës “Qesarit ia jep të drejtën që i takon Qesarit e Zotit atë që i takon Zotit”, mësimet e Jezusit (Isait a.s.) përfshijnë vetëm një pjesë të caktuar të jetës së tij. Ndërkaq për një musliman, mësimet e Islamit e ndërthejnë mbarë jetën duke mos lënë jashtë me këtë rast asnjë aspekt të saj.²

Mirëpo, përkundër vështirësive që hasen gjatë përkufizimit të fesë dhe gjatë identifikimit të tipareve dalluese që e karakterizojnë atë, përpjekjet në këtë drejtim nuk kanë reshtur dhe janë bërë përkufizime të ndryshme të fesë varësisht nga mënyrat dhe metodat e qasjes ndaj kësaj çështjeje. Ndër sociologë të religjionit ekziston tendenca që feja, nga aspekti i pjesëve përbërëse që duhet t'i zotërojë çdonjëra prej tyre, të përkufizohet si institucion shoqëror i cili ka sistemin doktrinor (të besimit), atë praktik (adhurimet dhe ritualet) si dhe mundësinë për t'u organizuar e për të krijuar grupe të mirëfillta shoqërore. Sipas kësaj, pra, çdo fe posedon idetë dhe botëkuptimin e vet lidhur me Qenien transcendentale, njeriun, botën e dukshme si dhe atë përtej saj; ka rregullat dhe format e adhurimit dhe flijimit që duhen kryer ndaj Qenies transcendentale (Zotit) si dhe ka strukturën e një komuniteti (xhema'ati) i cili zë fill dhe paraqitet gjatë kryerjes së rregullave dhe ritualeve në fjalë. Edhe pse të trija këto dimensione të fesë, pra Zoti, ligji dhe komuniteti nuk mund të ndahen nga njëra-tjetra sepse përbëjnë një tërësi të quajtur fe, sociologjia e religjionit para së gjithash merret me formimin, strukturën dhe dinamikën e komunitetit, ndërsa sistemin doktrinor dhe atë praktik i studion vetëm sa i takon varshmërisë që kanë këto me komunitetin.³

Sa për të ilustruar ngjashmërinë me një përkufizim të këtillë të fesë, këtu po e përmendim atë që dijetarët muslimanë gati në të gjitha shkencat fetare e sjellin për fenë në përgjithësi dhe Islamit

¹ Joseph Fichter, *Sosyoloji Nedir?*, përkth. Nilgün Çelebi, Ankara, bot. Atila, 1996, f. 125-126.

² Montgomery W. Watt, *Modern Dünyada İslam Vahyi*, përkth. M. S. Aydın, Ankara, 1982, f. 21.

³ Mustafa Aydın, *Kurumlar Sosyolojisi*, Ankara, bot. Vadi, 1997, f. 121; İzzet Er, *Din Sosyolojisi*, Ankara, bot. Akçağ, 1998, f. 4 - 5.

në veçanti: “Feja është tërësi rregullash dhe urdhëresash të kumtuara përmes pejgamberëve (të dërguarve) nga ana e Zotit për të siguruar lumturinë dhe mirëqenien e njerëzimit në këtë dhe në botën tjetër”.⁴

Edhe Joachim Wach-i, që është njëri ndër sociologët më kompetentë gjermanë të sociologjisë sistematike të religjionit, aspektet e objektivizimit të përvojës fetare i ndanë në tri grupe:

- aspekti teorik i përvojës fetare apo besimi (doktrina),
- aspekti praktik apo adhurimi (kulti),
- aspekti sociologjik apo komuniteti / bashkësia fetare.⁵

Sipas kësaj, pra, format e shprehjes dhe të objektivizimit të përvojës fetare manifestohen pikësepari përmes besimit (doktrinës) që e përbën thelbin dhe esencën e përvojës fetare, atë që disa e quajnë “përvoja apo përjetimi i së shenjtës”.⁶ Pas depërtimit, rrënjës dhe vendosjes së këtij besimi në shpirtat dhe në botëkuptimet e individëve pason faza tjetër e manifestimit të kësaj përvoje të cilën e përbëjnë lutjet, duatë, adhurimet, flijimet, kultet etj. Si pasojë e kësaj, kryerja e këtyre adhurimeve dhe ceremonive në një vend të caktuar dhe në mënyrë të organizuar e përbën elementin bazor për krijimin e një strukture të një grupi të organizuar fetar e me këtë edhe bazën e një shoqërie të mirëfilltë. Këto veçori të përvojës fetare dhe të manifestimit të saj në shoqëri më së miri mund t’i vërejmë te të gjitha fetë e shpallura e sidomos në fenë Islame.

B. GRUPET FETARE NË TETOVË DHE RRETHINË

Popullata që sot jeton në Tetovë dhe rrethinë u takon dy grupeve kryesore fetare: islame dhe krishtere. Të dhënat historike flasin se në Tetovë dhe rrethinë që nga lashtësia ka jetuar fisi ilir penest që ka qenë në fqinjësi me dardanët në veri dhe paionët në jug – gjithashtu fise ilire.⁷ Mirëfilli dihet se para përhapjes së krishterizmit në këto troje te fiset ilire ka dominuar paganizmi me format e ndryshme të tij.⁸ Krishterimi në këto anë dhe përgjithësisht në Iliri fillon të përhapet që në shek. I pas Isait.⁹ Me ndarjen e Kishës në atë lindore / ortodokse dhe perëndimore / katolike më 1054, Tetova me rrethinë bijnë nën juridiksionin e Kishës ortodokse gjë që akoma vazhdon të jetë e tillë. Sa i përket fesë Islame, ajo në këto troje me të madhe fillon të përhapet pas vendosjes së administratës osmane në Tetovë dhe rrethinë menjëherë pas rënies së Shkupit më

⁴ Ahmed Saim Kılavuz, *Anahatlarıyla İslam Akaidi ve Kelam'a Giriş*, Stamboll, bot. Ensar Vakfi, 1987, f. 7; Mahmud Şeltut, *Akaid ve Şeriat*, vëll. I, përkth. Muharrem Tan, Stamboll, bot. Yöneliş, 1991, f. 11.

⁵ Joachim Wach, *Sociologie de la Religion*, Paris, 1995, f. 21-51, cituar sipas Ünver Günay, *Din Sosyolojisi*, Stamboll, bot. İnsan, 1998, f. 217.

⁶ Po aty, f. 207.

⁷ Grup autorësh, *Historia e popullit shqiptar*, vëll. I, Prishtinë, 1968, f. 46; Grup autorësh, *Tetovo i Tetovsko niz Istorijata*, Tetovë, bot. Kuvendi i Komunës së Tetovës, 1982, f. 39.

⁸ Më gjerësisht shih: Aleksandër Stipçeviq, *Simbolet e kultit te ilirët*, Prishtinë, bot. Rilindja, 1983.

⁹ Zef Mirdita, “Gjashtë shekujt e parë të krishtenizmit në trevat iliro-shqiptare”, në *Krishtërimi ndër shqiptarë-Simpozium Ndërkombëtar*, Shkodër, bot. Phoenix, 2000, f. 37; Bibla, Rom XV 19.

1392.¹⁰ Islami më parë përhapet në mesin e qytetarëve e sidomos të timariotëve vendas e më pas edhe ndër popullatën e gjerë fshatare.¹¹

Ja si do të dukej sot në mënyrë tabelare shtrirja e grupeve fetare në Pollogun e Poshtëm (Tetovë me rrethinë) bazuar në të dhënat e Entit Statistikor në Republikën e Maqedonisë sipas regjistrimit të vitit 1994 dhe sipas ndarjes territoriale-administrative të vitit 1996, për të cilat jemi përcaktuar për shkak të mungesës së të dhënave të këtylla nga ndonjë institucion tjetër relevant.¹²

Komunat	Popull. e përgjith.	Orto- doksë	Kato- likë	Prote- stanë	Musli- manë	Pjes. të feve të tjera	Ate-istë	Pa përgjigje
Bërvenica	14.793	5.940	4	1	8.708	6	-	134
Bogovina	13.001	50	10	-	12.757	5	-	179
Jegunovca	7.013	4.803	8	-	2.165	5	1	31
Kamjani	12.136	31	2	-	11.965	4	-	134
Shipkovica	6.797	21	3	1	6.670	3	-	99
Tearca	20.797	2.878	8	1	17.583	11	1	315
Tetova	65.318	21.379	140	8	43.141	22	42	586
Vratnica	3.270	1.459	2	-	1.787	-	1	21
Xhepçishti	7.286	108	-	-	7.096	1	-	81
Zhelina	21760	72	11	2	21.456	3	-	216
Gjithsejt	172.171	36.741	188	13	133.328	60	45	1.796
%	100	21.33	0.10	0.00	77.43	0.03	0.02	1.03

Tabela 1. Shtrirja e grupeve fetare në komunat e Pollogut të Poshtëm sipas regjistrimit të vitit 1994.¹³

Nga të dhënat tabelare mund të konstatojmë se grupin më të madh fetar këtu e përbëjnë muslimanët me 77,43 %, pjesën dërmuese të të cilëve e përbëjnë muslimanët sunnitë të drejtimit hanefij dhe një grup thuaja i pahetueshëm i tarikatis bektashian. Grupin e dytë fetar për nga

¹⁰ Nadi Bilmenoğlu, *Kalkandelen, Dün ve Bugün*, Stamboll, bot. privat, 1975, f. 29.

¹¹ *Tetovo i Tetovsko niz...*, f. 125-128.

¹² Për mangësitë e këtij regjistrimi shih: Fauzi Skenderi, *Popullsia e Pollogut të Poshtëm (Studim demografik)*, Tetovë, 2000, f. 19. Në ndërkohë, në nëntor 2003 është bërë regjistrimi i ri i popullsisë në Republikën e Maqedonisë, mirëpo akoma nuk janë shpallur rezultatet përfundimtare të këtij regjistrimi që gjithsesi duhet dhe pritët që më realisht ta reflektojë strukturën e vërtetë të kësaj popullsie.

¹³ *Zavod za statistika na Republika Makedonija, Popis na naselenieto, domačinstvata, stanovite i zemjodelskite stopanstva vo Republika Makedonija, 1994 godina*, libri XIII, Shkup, 1997, f. 73-78.

madhësia e përbëjnë të krishterët me 21,43 %. Të krishterët e këtushëm kryesisht i takojnë rritit ortodoks, ndërsa një numër më i vogël i tyre i takojnë rritit katolik dhe atij protestan.

Sa i përket përkatësisë kombëtare të këtyre grupeve religjioze në bazë të të dhënave të entit të lartpërmendur mund të konstatojmë se shqiptarët, turqit, romët dhe torbeshët në tërësi i takojnë grupit fetar musliman, kurse maqedonët, vlllehët dhe serbët kryesisht i takojnë grupit fetar krishter të rritit ortodoks dhe një numër shumë i vogël atij katolik dhe protestan.¹⁴

C. JETA FETARE (RELIGJIOZITETI) NË TETOVË DHE RRETHINË

Njëra ndër problemet qendrore metodologjike e cila paraqitet në çdo studim konkret të sociologjisë së religjionit me rastin e dallimit dhe identifikimit të tipeve kryesore të religjiozitetit / jetës fetare është problemi rreth përcaktimit të kriterit të religjiozitetit: cili individ i shoqërisë të quhet religjioz dhe ç'janë tiparet me të cilat dallohet ai prej atij që është i luhatshëm në këtë aspekt apo edhe prej atij që s'beson fare? Pra, cili do të jetë kriteri në bazë të të cilit do të mund ta matnim masën dhe intensitetin e besimit apo të religjiozitetit të një individi të caktuar apo edhe të një shoqërie të tërë? Përkundër kriterëve të ndryshme dhe të numërta që i sjellin sociologët në këtë drejtim, si zakonisht dominon ideja se për këtë vlen vetëm një kriter e që është deklarimi personal i individëve të vështruar apo të anketuar duke mos i përjashtuar as edhe kriteret tjera relevante.

Për sa i përket studimit të shtrirjes, formave dhe tipeve të religjiozitetit në Tetovë dhe rrethinë ne nuk kemi përdorur teknikën e anketimit, porse krahas vrojtimit subjektiv tonat lidhur me territorin në fjalë jemi mbështetur kryesisht edhe në punimin e mr. Stefan M. Kostovskit të titulluar *Religjia kaj sellskoto naselenie vo Dollni Pollog* ("Religjioni te popullata rurale e Pollogut të Poshtëm") të botuar nga Instituti për studime sociologjike dhe politiko-juridike pranë Universitetit 'Kirili dhe Metodi' në Shkup më 1972. Përkundër elementeve të ideologjisë marksiste që hasen në pjesën teorike të studimit, në parashtrimin e qëllimeve të tij si dhe në vlerësimin dhe interpretimin e rezultateve të këtij studimi, përkundër kohës relativisht të hershme kur është punuar studimi, vetë realizimi i anketës dhe rezultatet e saj na duken objektive dhe çmojmë se në masë të konsiderueshme e reflektojnë gjendjen reale në terren. Duke u mbështetur në këtë konstatim, ne këtu do të sjellim rezultatet e anketës në fjalë në mënyrë të rezymuar duke patur për qëllim hedhjen dritë mbi këtë çështje.

Studimi i shtrirjes, intensitetit dhe formave të religjiozitetit në Pollogun e Poshtëm ka treguar këto rezultate:

"Rezultatet për aktivitetin e bashkësive fetare këtu në Pollogun e Poshtëm kanë treguar se Bashkësia fetare muslimane zhvillon një aktivitet fetar shumë më të dendur. Ky aktivitet manifestohet veçmas në ngritjen e objekteve të reja fetare dhe në organizimin e mësimin fetar për fëmijët e moshës 7-14 vjeçare. Me një aktivitet të këtillë kjo Bashkësi fetare shumë më tepër po i

¹⁴ Po aty, libri I, Shkup, 1996, f. 50.

intensifikon ndjenjat fetare të besimtarëve dhe krijon kushte reale, sidomos nëpërmjet shkollave fetare, për një aktivitet fetar akoma më të bujshëm.

Konfesionin ortodoks i viseve në fjalë nuk zhvillon ndonjë aktivitet intensiv që do të rezultonte me zgjerimin dhe intensifikimin e ndjenjave dhe nevojave fetare. Aktivitetet e këtij konfesionin në të shumtën e herave reduktohen në kryerjen e veprimeve rituale (varrime, pagëzime, bekime të ujit etj.). Në këtë konfesion shumë festa fetare më tepër përjetohen si tradita e zakone se sa si festa të mirëfillta fetare.

Rezultatet nga studimi i shtrirjes së formave të religjiozitetit kanë treguar se sipas indikatorit “përcaktimi personal fetar”, në viset e analizuara dominojnë:

- besimtarët.....66,9 %
- të papërcaktuarit.....16,4 %
- jobesimtarët.....10,4 %
- ateistët.....6,3 %.

Sa i takon manifestimit të religjiozitetit, rezultatet kanë treguar se në këto vise disa forma të religjiozitetit janë më të shtrira se disa të tjera. Ja si do të dukej rradhitja apo hierarkia e disa formave të ndryshme të religjiozitetit:

- besimi në Zotin.....66,5 %
- kryerja e rregullt e detyrave fetare....64,8 %
- nevoja e njeriut për fenë.....55,3 %
- shkuarja e rregullt në kishë / xhami...51,5 %
- besimi në botën e pasvarrit.....39,8 %.

Rezultatet lidhur me shtrirjen e formave të religjiozitetit në varshmëri me disa variable sociodemografike të të anketuarve kanë treguar:

- marrë në përgjithësi, të gjitha format e matura të religjiozitetit më tepër shtrihen në konfesionin musliman (islam). Të anketuarit që i takojnë konfesionit musliman shumë më tepër besojnë Zotin, më rregullisht i kryejnë detyrat fetare, më rregullisht shkojnë në xhami dhe më shumë besojnë në jetën e përtejvarrit.
- meshkujt, sipas rezultateve, tregojnë shkallë më të ulët të participimit të tyre në sjelljet fetare, gjegjësisht shtrirje më të vogël të religjiozitetit.
- manifestimi i formave të ndryshme të religjiozitetit ndryshon sipas moshës së të anketuarve. Më të moshuarit më tepër besojnë Zotin, më tepër i kryejnë rregullat fetare, më tepër shkojnë në kishë / xhami etj.
- të gjitha trajtat e religjiozitetit më së shumti hasen te amviset, te bujqit, te punëtorët, kurse më pak te nëpunësit, te nxënësit dhe te studentët.
- me rritjen e arsimimit, pra, të përgatitjes shkollore të të anketuarve, bie religjioziteti sipas të gjithë indikatorëve (besimi në Zotin, kryerja e rregullave fetare, shkuarja në kishë / xhami dhe besimi në jetën e përtejvarrit).

Rezultatet nga përpjekja për tipizimin e religjiozitetit ku krahas dy tipave të skajshëm – “besimtar” dhe “ateist”- hasen edhe tipat e ndërmjetëm si “ateist stihik / jobesimtar pasiv” dhe “i papërcaktuar / besimtar i luhatshëm”, kanë treguar se në viset e analizuara vërehet një shtrirje e tipave të veçuar të religjiozitetit si më poshtë:

- i bindur tradicionalisht (besimtar aktiv).....65,5 %
- i papërcaktuar (besimtar i luhatshëm).....17,5 %
- ateist stihik (jobesimtar pasiv).....12,0 %
- i bindur racionalisht (ateist aktiv).....4,0 %.

Origjina konfesionale, gjegjësisht përkatësia ndaj një konfesionit të caktuar, është e rëndësishme për shkak se nga shkalla e ndikimit të bashkësisë fetare në jetën fetare të anëtarëve të tyre varet edhe procesi i lëshimit të fesë - ateizimit.

Religjioziteti (tipet e religjiozitetit), shikuar nga aspekti i përkatësisë fetare të të anketuarve, tregon se numri i besimtarëve të bashkësisë fetare muslimane është dukshëm më i madh krahasuar me numrin e besimtarëve të bashkësisë fetare ortodokse (92,2 % besimtarë të konfesionit islam kundrejt 66,9 % besimtarë të atij ortodoks).

Analiza e të dhënave lidhur me ndikimin e gjinisë mbi intensitetin dhe shtrirjen e religjiozitetit ka treguar se femrat janë më fetare (91,4 % besimtare kundrejt 76,7 % besimtarë).

Analiza e variableve të moshës dhe të religjiozitetit ka treguar se numri i besimtarëve rritet në varshmëri me rritjen e moshës së të anketuarve (34,9 % besimtarë tradicionalë dhe 29,6 % të luhatshëm nga mesi i të rinjve të moshës 15-25 vjeç, kundrejt 97,7 % besimtarë tradicionalë dhe 2,3 % të luhatshëm nga të anketuarit e moshës 66 e më tepër vjeçare).

Profesioni i të anketuarve si faktor i diferencimit të relacionit (qëndrimit) ndaj fesë shtriton një rradhitje të besimtarëve si vijon (nga shkalla më e lartë drejt më të ultës): amvise 93,5 %, bujq 87,8 % dhe punëtorë-zejtarë 64,4 %.

Numri i besimtarëve zvogëlohet me rritjen e përgatitjes arsimore të të anketuarve (nga 100 % besimtarë nga mesi i të anketuarve të pashkolluar, 94,5 % me arsim katër vjeçar, 59,2 % me arsim tetë vjeçar, deri në 0,06 % nxënës-studentë, gjegjësisht të anketuar me arsim të mesëm, të lartë dhe superior).¹⁵

Sipas një ankete që është realizuar në vitin 1991, afro dy të tretat (64.3 %) e popullsisë së Maqedonisë “besojnë Zotin” (në vitin 1990 ky përpjesëtim ka qenë 36.4 %), 57.6 % e ndjejnë veten si fetarë dhe më tepër se katër të pestat e kësaj popullsie është e mendimit se feja është e nevojshme për njeriun. Në bazë të kësaj ankete është konstatuar se ekziston një dallim i rëndësishëm midis pjesëtarëve të dy grupeve më të mëdha fetare në vend nga aspekti i përkatësisë kombëtare të tyre. Kështu, “Zotin besojnë” 97 % e shqiptarëve dhe turqve të cilët e përbëjnë grupin fetar të muslimanëve, përkundrazi 55 % të maqedonëve të krishterë.¹⁶

Ndërkaq, mr. Ali Pajaziti, në punimin e tij të magistraturës të titulluar *Geçish Sürecinde Makedonya, Üniversite Gençliği ve Din Olgusu* (Maqedonia në periudhën e tranzicionit shoqëror (1990-1997), Rinia universitare dhe religjioni /studim sociologjik/), trajton çështjen e besimit fetar, praktikës fetare, botëkuptimit fetar etj. në mesin e studentëve të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”- Shkup, ku përfshihen edhe studentë nga Tetova dhe rrethi i saj. Sa i përket indikatorit “*Besoj Zotin*”, Pajaziti ka konstatuar këtë gjendje:

¹⁵ Stefan M. Kostovski, *Religijata kaj sellskoto naselenie vo Dollni Pollog*, Shkup, bot. Instituti për studime sociologjike dhe politiko-juridike, 1972, f. 107-109.

¹⁶ Ilija Acevski, “Religioznosta na naselenieto vo Republika Makedonija”, në *Godishen Zbornik na Filozofskiot Fakultet na Univerzitetot vo Skopje*, libri 19 (45), 1992, f. 206.

- (sipas variablit të gjinisë) 69.4 % e studenteve besojnë Zotin, përkundër studentëve me 81.4 %,
- (sipas variablit të vendbanimit) në këtë besim studentët me vendbanim në qytet marrin pjesë me 72.9 %, ata të fshatit me 93 %, kurse ata që vijnë prej jashtë vendit me 100 %,
- (sipas variablit të përkatësisë kombëtare) studentët shqiptarë marrin pjesë me 98.4 %, ata maqedonë me 58.9 %, turq me 83.3 %, boshnjakë me 100 %,
- (sipas variablit të përkatësisë fetare) studentët muslimanë participojnë me 97,3 %, përkundër atyre ortodoksë me 59.5 %.

Sipas indikatorit “*Besoj në botën e pasvarrit / Ahiret*”, Pajaziti konkludon:

- studentët nga qyteti besojnë në botën pas kësaj me pjesëmarrje prej 71.9 %, ata prej fshati 90.2 %,
- studentët muslimanë marrin pjesë me 96 %, kurse ata ortodoksë me 57.4 %,
- studentët shqiptarë 96.9 %, ata maqedonë 56.2 %, turq 83.3 %, boshnjakë 100 %.

Lidhur me intensitetin e ushtrimit të detyrave fetare nga ana e studentëve, rezultatet e Pajazitit janë si më poshtë:

- “mundohem t’i kryej sa më rregullisht”: vajzat 22.3 %, djemtë 27.5 %,
- “i kryej kur gjej kohë”: vajzat 57.7 %, djemtë 47.9 %,
- “dëshiroj t’i kryej po s’mundem”: vajzat 9.4 %, djemtë 15.8 %,
- “nuk kryej asnjë detyrë fetare, sepse nuk besoj”: vajzat 8.2 %, djemtë 8.8 %.

31.3 % e studentëve shqiptarë mundohen t’i kryejnë rregullisht detyrat fetare, prej studentëve maqedonë 19.8 %, prej turqve 41.7 % dhe prej boshnjakëve 44.4 %. Për indikatorin “nuk kryej asnjë detyrë fetare sepse nuk besoj” janë shprehur 2.3 % e studentëve shqiptarë, 14.4 % maqedonas, 16.7 % turq. Sa i përket variablit të përkatësisë fetare kemi këto rezultate: 32.9 % e studentëve muslimanë shprehen se mundohen t’i kryejnë rregullisht detyrat fetare, ndërsa prej ortodoksëve për këtë shprehen 20.5 %. 47 % e studentëve muslimanë shprehen se “i kryejnë kur gjejnë kohë”, prej ortodoksëve shprehen 54.6 %. “Dëshiroj t’i kryej po s’mundem” shprehen 16.1 % studentë muslimanë dhe 12.1 % ortodoksë. Për indikatorin “nuk kryej asnjë detyrë fetare sepse nuk besoj” janë shprehur 3.3 % e studentëve muslimanë dhe 12.1 % prej atyre ortodoksë.¹⁷

¹⁷ Ali Pajaziti, *Maqedonia në periudhën e tranzicionit shoqëror (1990-1997), Rinia universitare dhe religjioni /studim sociologjik/*, Logos-A, 2003, Prishtinë, f. 96-97, 100-101, 110-111.

D. FAKTORËT QË NDIKOJNË NË JETËN FETARE TË MUSLIMANËVE NË TETOVË ME RRETHINË

Që në fillim të theksojmë se këtu nuk do të merremi me faktorët e brendshëm që e motivojnë sjelljen apo jetën fetare siç janë, p.sh.: frustracioni (pengimi), ndjenja e fajësisë, kërkimi i identitetit, dëshira për integritim, brenga, nevoja për të kuptuar e për të sqaruar, nevoja për harmoni sociale, ruajtja e vlerave morale, ndjenja e varshmërisë etj., sepse me këto çështje më drejtpërdrejt merret psikologjia e religjionit ndaj edhe për këtë problem preferohet literatura përkatëse.¹⁸ Këtu do t'i shqyrtojmë faktorët socialë të cilët në mënyrë të vetëdijshme dhe të organizuar ndikojnë në kultivimin, shtrirjen dhe intensitetin e sjelljes dhe të jetës fetare islame në Tetovë dhe rrethinë duke e lënë anash kësaj rradhe proviniençën krishtere.

1) Bashkësia Islame – Myftynia e Tetovës

Bashkësia Islame e Maqedonisë është organizatë e pavarur, sovrane, e cila vepron si subjekt juridik mbi baza të normave e parimeve islame si dhe të ligjeve në fuqi. Ajo ka trupat, organet dhe sektorët e vet, siç janë: Institucioni i Reisu'l-Ulemasë, Mexhlisi Shura, Mexhlisi Juridiko-Financiar dhe myftynitë.¹⁹ Në strukturën e saj ajo përfshinë 13 myftyni njëra prej të cilave është edhe ajo e Tetovës e cila e mbulon tërë rajonin e Pollogut të Poshtëm. Myftynia ka Mexhlinin (Kuvendin) e vet të përbërë prej 15 anëtarësh të cilët zgjedhen nga këshillat e xhamive. Përveç personelit administrativ të Myftynisë prej 9 vetësh si nëpunës të tjerë të saj veprojnë edhe imamët, vaizët, hatibët, mual-limët si dhe muezzinët e xhamive numri i përgjithshëm i të cilëve arrinë shifrën prej 124 vetësh. Ky kuadër fetar luan rol të rëndësishëm në ngritjen dhe zhvillimin e botëkuptimit e të sjelljeve fetare ndër popullatën vendëse përmes aktiviteteve që i zhvillon ai kryesisht në dy institucionet fetare bazë edhe atë nëpër a) Xhamitë dhe b) Mektebet.

a) Xhamitë

Xhamitë, si institucione të mirëfillta fetare dhe që herë-herë kanë patur edhe funksione të ndryshme sociale, kulturore, arsimore etj., në Tetovë dhe rrethinë i hasim qysh me depërtimin e Islamit në këto troje.

¹⁸ Shih p.sh.: Hayati Hökeleki, *Din Psikolojisi*, Ankara, bot. Türkiye Diyanet Vakfi, 1996, f. 79-121; Antoine Vergote, *Psychologie Religieuse*, Bruksel, bot. Charles Dessart, 1969; I njëjti autor, *Religion, Foi, Incroyance*, Bruksel, bot. Pierre Mardaga, 1983; Gordon W. Allport, *The Individual and His Religion, A Psychological Interpretation*, Nju Jork-Londër, bot. Macmillan, 1960; etj.

¹⁹ Behixhuddin Shehapi, *Bashkësia Islame dhe institucionet e saj*, Shkup, bot. Mexhlisi Shura i BI të Maqedonisë, 1997, f. 6.



Foto-2 : Xhamia Eski (e Vjetër) në Tetovë, e ndërtuar nga Isa Beu.

Ja si e përshkruan qytetin e Tetovës dr. Ayverdi në një edicion të tijin: “Qyteti i Tetovës që gjendet nja 22 km. (38 km.-R.N.) në perëndim të Shkupit është një qytet i rëndësishëm osman. Ka një sërë xhamish edhe pse sot numri i tyre është reduktuar dukshëm. Është i njohur edhe për teqetë. Sipas Sallnames së Kosovës të vitit 1314 (1898) në qytetin e Tetovës ka patur 12 xhami, 4 medrese, 7 teqe, 9 mektebe, 2 hamame, 10 hane, 100 çeshme, 1 bibliotekë dhe 5 ura”.²⁰

Sot në Tetovë bashkë me pjesën rurale të saj aktive janë 83 xhami, prej të cilave 7 vetëm në qytet*. Ndërtimi i xhamive realizohet përmes kontributeve vullnetare të besimtarëve vendas. Secila xhami ka nga një imam (hoxhë që prin në namaz), ndërsa në fshatrat dhe lagjet më të mëdha përveç imamit detyrë kryejnë edhe vaizi (ligjëruesi), mual-limi (mësuesi fetar) dhe muezzini (personi që e thërret ezanin). Shumica e këtij kuadri është shkolluar në universitete të ndryshme të botës arabe, turke dhe në atë të Bosnjës. Përveç prirjes në faljet e rregullta të namazeve ditore dhe javore prijësi fetar (imami / vaizi) mundohet që besimtarëve të vet t’ua përcjellë dhe kumtojë mësimet, moralin dhe kulturën fetare përmes ligjëratave javore të së premtës (xhumasë), kurse gjatë muajit të Ramazanit ligjëratat të këtilla mban një ose dy herë në

²⁰ Ekrem H. Ayverdi, *Avrupa'da Osmanlı Mimari Eserleri, Yugoslavya*, v. III, libri 3, Stamboll, 1981, f. 75.

* Në vitin 2003 në qytetin e Tetovës është hapur edhe një xhami në lagjen Teqe, kurse në kompleksin e Teqesë Harabati Baba të Tetovës është aktivizuar edhe mesxhidi i saj, kështu që sot numri i xhamive aktive në qytet është 9.

ditë. Këtu gjithsesi duhet marrë në konsideratë edhe shërbimet dhe aktivitetet e kuadrit fetar që ai i kryen jashtë xhamisë, si: vënia e emrit (pagëzimi) të foshnjave, leximi i mevludit dhe duasë së synetimit, vënia e kurorës së dy të rinjve në dasmën e martesës, larja e xhenazes dhe falja e namazit të saj, këndimi i hatmes apo mevludit para varrimit dhe një javë pas varrimit të xhenazes etj. Në të gjitha këto raste dhe të ngjashme me këto, imami luan rolin e prijësit fetar apo të “agjentit ideologjik”. Me këtë rast vlen të përmendet sidomos leximi i hatmes (Kur’anit në tërësi) dhe mevludit (poezi epike kushtuar Muhammedit a.s.). Pasi këto ceremoni për disa familje nënkuptojnë tërë religjiozitetin, gjegjësisht jeta e tyre fetare fillon dhe mbaron me to, nëpunësi fetar mundohet që këto raste t’i shfrytëzojë maksimalisht për kryerjen e misionit që bart. Leximi i hatmes dhe këndimi i mevludit nuk bëhen vetëm në dasmën e synetimit dhe me rastin e vdekjes së ndonjë besimtari, porse ato kanë marrë formën e një tradite fetare dhe organizohen edhe në netët që fetarisht quhen të mëdha dhe me rastin e festave e ceremonive të ngjashme me këto. Duke marrë parasysh se këndimi i mevludit bëhet në shtëpinë e besimtarit që e organizon atë, ky është rasti i volitshëm e për ndonjë familje edhe i vetëm për t’u takuar me nëpunësin fetar (hoxhën) e për të biseduar me të gjerë e shtruar për çështje fetare, sociale, kulturore etj. Këtu duhen cekur edhe mbresat e thella që i lë këndimi i mevludit në shpirtat e njomë të fëmijëve dhe të rinjve që prezentojnë në këndimin e tij si dhe të grave e plakave që e dëgjojnë atë me plot qejf e kënaqësi.

Nëpunësi fetar, përveç xhamisë dhe mevludit, merr pjesë edhe në ceremoni e raste gëzimi dhe zije, në kafene e lokale të ngjashme me këto dhe mundohet që të jetë sa më afër besimtarëve të vet, të krijojë lidhje shoqërore sa më të sinqerta me ta dhe t’u bëhet shembull jete në këtë drejtim.

b) Mektebet

Meqë në Republikën e Maqedonisë mësimi i besimit dhe kulturës fetare akoma nuk është integruar në sistemin e përgjithshëm arsimor*, vendet e vetme në të cilat që prej kohësh zhvillohet arsimi fetar janë mektebet, ndërtesa të përbëra kryesisht prej një a dy klasash dhe që ndodhen pranë apo edhe ngjitas me xhamitë. Në vendet ku mungojnë mektebet mësimi fetar zhvillohet brenda në xhami. Deri para disa vjetësh mësimi fetar nuk është zhvilluar sipas ndonjë plani dhe programi të caktuar të hartuar nga Bashkësia Islame e Maqedonisë, porse kjo rëndom është varur nga metoda dhe përgatitja profesionale e vetë mual-limit. Mungesa e një planprogrami të mirëfilltë në këtë drejtim mund të shpjegohet me disponimin e politikës ditore ideologjike të regjimit komunist e cila ka qenë kundër një arsimimi të këtillë. Mësimi i këtillë edhe pse ka qenë në kundërshtim me ideologjinë marksiste dhe i ndaluar me ligj, ai përsëri ndiqej edhe pse thuhet se te nxënësit fut iluzion lidhur me socializmin shkencor.²¹ Mirëpo kjo gjendje është tejkaluar me kalimin e shoqërisë nga sistemi monist në atë pluralist kur edhe është lejuar ndjekja e arsimit fetar edhe atë sipas planprogramit të hartuar nga Bashkësia Islame e

* Në vitin shkollor 2002 / 2003, në bazë të vullnetit të prindërve e nxënësve si dhe të disponimit të Ministrisë së Arsimit në Republikën e Maqedonisë, vetëm për klasat e treta filllore, është futur edhe mësimi fetar si lëndë fakultative. Të shpresojmë që kjo nismë të përhapet edhe nëpër klasat e nivelet e tjera të arsimit fillor e të mesëm!

²¹ Lidhur me vështirësitë e vijimit të mësimi fetar gjatë periudhës së pasluftës së dytë botërore më gjerësisht shih: Avzi Mustafa, *Zhvillimi i shkollës fillore shqipe në Republikën e Maqedonisë (1945-1975)*, Shkup, bot. Logos-A, 1998, f.48-49. Lidhur me situatën e këtij arsimit në periudhën midis dy luftërave botërore shih: I njëjti autor, *Edukata dhe arsimiti nëpër shekuj*, Shkup, bot. Shkupi, 1997, f. 111 e më tej.

Maqedonisë sipas të cilit fëmijët prej moshës shtatë vjeçare në disa shkallë mësojnë leximin e Kur'anit, bazat e besimit, rregullat e ibadeteve (adhurimeve), etikën islame dhe historinë islame.

Arsimi fetar nëpër mektebe përfundon me mbarimin e të gjitha katër shkallëve dhe me dorëzimin e diplomave të lëshuara nga Myftynia me ç'rast në xhami organizohet edhe ceremoni e posaçme me këndim të pjesëve të Kur'anit e të ilahive dhe përfundon me dua e lutje.

Pas mbarimit të këtyre katër shkallëve disa nxënës që dëshirojnë nxënien përmendsh të mbarë Kur'anit (hifdhin) rëndom këtë e bëjnë te mual-limi i mirënjohur i Tetovës Mahmud ef. Asllani i cili vepron në Xhaminë e Larme-të Pashës në Tetovë dhe i cili deri më tani ka nxjerrë më se 100 hafidhë të Kur'anit.

Numri i nxënësve që tani për tani e ndjekin mësimin fetar në 71 mektebet e Tetovës dhe rrethinës sillet rreth 10.000 djem e vajza.²²

2) Shoqatat e ndryshme fetare dhe aktivitetet e tyre

a) Shoqata fetare “MEXHLISI”

Shoqata fetare “Mexhlisi” është formuar më 1984 në Tetovë me qëllim të ringjalljes dhe organizimit të jetës fetare ndër rininë muslimane të Tetovës me rrethinë. Deri kah vitet e '90 ka vepruar ilegalisht duke e shfrytëzuar një kafene si vend takimi me anëtarët e vet. Pas ndryshimeve socio-politike në vend, kjo shoqatë vendoset në një shtëpi në Tetovë ku edhe i vazhdon aktivitetet e saj si bisedat dhe takimet fetare javore dhe mujore me anëtarët e vet të cilët kryesisht janë të moshës 20-30 vjeçare dhe që ushtrojnë profesione të ndryshme, si: mësues, nxënës-studentë, zejtarë, tregtarë etj. Takime të këtilla organizohen ndaras edhe për vajzat e gratë muslimane të rajonit.

Në vitin 1992 Shoqata themelon shtëpinë botuese “ASR” e cila deri më tani ka botuar te dhjetëra tituj me karakter fetar. Po të njëjtin vit Shoqata e hap edhe librarinë e saj “ASR”. Që nga viti 1994 Shoqata “Mexhlisi” fillon botimin e revistës për fëmijë “Dritarja”. Shoqata zotëron edhe kafenenë “ASR” e cila luan rolin e klubit të saj.

Nëntë vjet me rradhë organizon “Kuizin Tradicional të Diturisë” gjatë muajve të Ramazanit përmes të cilit mundohet të bëjë bartjen dhe përcjelljen e njohurive fetare te të rinjtë që marrin pjesë aktive në të ose si spektatorë. 3-4 vitet e fundit këto kuize i organizon në bashkëpunim me Myftyninë e Tetovës. Gjatë muajit të Ramazanit Shoqata organizon shtrimin e iftareve për studentët dhe të rinjtë e tjerë duke u munduar kështu të bëjë integrimin e mbarë rinisë muslimane të Tetovës me rrethinë. Përveç librave dhe revistës me të cilat merr pjesë në “Panairin e Librit” që rregullisht organizohet në muajin tetor në Pallatin e Kulturës në Tetovë, Shoqata ka hapur edhe faqen e saj të internetit (www.asr.com.mk) në të cilën kryesisht i prezenton idetë dhe fetvatë e Muhammed Said Ramadan el-Butit.

²² Të dhënat për Bashkësinë Islame-Myftyninë e Tetovës i kemi siguruar nga kuadri administrativ dhe referentët arsimorë pranë Myftinisë së Tetovës. U jemi mirënjohës!

b) Shoqata fetare “RUMI”

Shoqata fetare “Rumi” e cila është themeluar kah vitet e '90 në Tetovë, angazhimin e saj e ka orientuar kryesisht në veprimtari botuese. Më 1991 e themelon shtëpinë botuese “Rumi” e cila ka botuar më se 20 tituj, shumica përkthime të punimeve të mendimtarëve shiitë për çka shpesh edhe është kritikuar nga besimtarët sunnitë të Tetovës për propagandim të mësimëve dhe vlerave shiite në mesin e sunnitëve. Mirëpo, në takimin që kemi patur me përfaqësues të kësaj shoqate na është bërë me dije se ata nuk bartin qëllime të tilla, porse angazhohen për prezantimin dhe njoftimin me veprat fetare, kulturore dhe artistike të këtyre dy “botëve” islame të cilat një kohë të gjatë po jetojnë thuaja të izoluar tërësisht nga njëra-tjetra. Shoqata ka hapur edhe librarinë e saj “Rumi” ku bën shitjen e veprave dhe revistave shiite dhe sunnite. Ajo ka ndihmuar në hapjen e një sërë bibliotekash të vogla nëpër fshatrat përreth Tetovës duke i furnizuar ato me tituj të lëmive të ndryshme. Përveç veprimtarisë botuese shoqata bën përkthimin nga gjuhë të huaja të filmave dhe përgatit programe të ndryshme me karakter fetar dhe kulturor për televizionet dhe radiot lokale private.

Edhe pse posedon një masë anëtarësh të përbërë kryesisht nga qytetarët e Tetovës dhe të disa qyteteve të tjera të vendit që u takojnë profileve profesionale të ndryshme, Shoqata rregullisht organizon biseda e takime fetare, shkencore dhe kulturore, bën promovimin e librave të ndryshëm dhe organizon konferenca të nduarnduarta shkencore e fetare. Ja si i përshkruajnë synimet dhe idealet e Shoqatës përfaqësuesit e saj:

- Ringjallja e vlerave kulturore dhe tradicionale të popullatës vendëse,
- Hulumtimi dhe identifikimi i rrugëve të shpëtimit nga zbrazëtira kulturore, morale dhe shpirtërore e cila e ka kapluar popullatën vendëse e sidomos rininë e saj,
- Prezantimi dhe afrimi i botëkuptimeve të ndryshme në sferën kulturore, intelektuale, sociale, artistike etj.

Shoqata fetare “Rumi” ka faqen e vet në internet: www.rumiweb.net .

c) Shoqata e femrave muslimane “ISLAMI DHE SHKENCA”

Shoqata “Islami dhe Shkenca” e cila kryesisht angazhohet për mbrojtjen e të drejtave të femrave muslimane në Tetovë dhe në mbarë vendin, për ringjalljen e vlerave shkencore dhe fetare, vetëdijësimin e femrave në këtë plan, gjetjen e pikave të përbashkëta me konfesionet e tjera, krijimin e bashkëpunimit të mirëfilltë me të gjitha shoqatat simotra në vend etj., është themeluar në vitin 1999 në Tetovë dhe, megjithëse është një shoqatë relativisht e re, për një kohë të shkurtër prej 2-3 vjetësh ka arritur që përreth vetes të tubojë një numër të konsiderueshëm të vajzave të reja, studenteve dhe femrave të profesioneve të ndryshme, 90 % e të cilave kanë mbaruar ose janë në mbarim e sipër të arsimit të lartë dhe superior në lëmi të ndryshme shkencore. Deri më tani ka arritur të hapë degën e saj në qytetin fqinj të Gostivarit ku i shtrinë edhe aktivitetet e saj të llojllojshme që i zhvillon në qytetin bazë, si: përgatitja e emisioneve fetare dhe shkencore për radiot private, zhvillimi i ligjëratave javore me tematikë fetare për studentet e nxënëset, organizimi i tribunave mujore për femrat muslimane, organizimi i kurseve për gjuhën arabe dhe angleze, zhvillimi i mësimin fetar për fëmijë në lokalet e saj të emëruar “Ndriçimi i rrugës së

fatosëve” etj. Në vitin 2000 fillon ta botojë edhe revistën për femra “Medina” e cila në përgjithësi trajton tema fetare dhe shkencore që kanë të bëjnë kryesisht me çështjet e femrave muslimane të vendit.²³

d) Komuniteti Bektashian në Tetovë

Ndër faktorët që ndikojnë në ngritjen e vetëdijes fetare islame në Tetovë dhe rrethinë këtu duhet përmendur edhe një institucion i cili për shkak të rolit që ka luajtur në të kaluarën në këtë drejtim, e jo edhe sot, meriton të përmendet e të shqyrtohet. Është fjala për teqenë Harabati Baba e cila i ka takuar tarikatit (drejtimit) mistik bektashian.

Sersem Ali Dedeja ishte ai që i pari e solli bektashizmin në Tetovë. Sersem Ali Dedeja ka qenë kunat i Kanuni Sulltan Sulejmanit dhe me urdhër të tij më 1538 nga dergjahu i Dimetokës (Greqi) nisët për në Tetovë ku menjëherë fillon t’i përhapë idetë e tarikatit bektashian e më pas më 1548 fillon edhe ndërtimin e një teqeje në veriperëndim të qytetit të Tetovës e cila akoma dhe sot qëndron në këmbë.²⁴ Kompleksi i kësaj teqeje është riparuar disa herë dhe më në fund aty kah vitet 1800-1820 në kohën dhe me ndihmën e Rexhep dhe Abdurrahman pashajve i është



Foto-3 : Faltorja kryesore (Kubbeli meydanı) e Teqesë Harabati Baba në Tetovë, e ngritur në shek. XVI.

²³ Të dhënat për shoqatat fetare në fjalë dhe për aktivitetet e tyre i kemi siguruar nga përfaqësuesit apo udhëheqësit e tyre në bisedat e drejtpërdrejta që i kemi zhvilluar me ta. I falënderojmë përzemërsisht!

²⁴ Nadi Bilmenoğlu, po aty, f. 48-49.

veshur pamja e stolisur që e ka edhe sot.²⁵ Pas kthimit të Sersem Ali Dedesë në Stamboll me ftesë të Kanuni Sulejmanit, për zëvendës të vetin dhe udhëheqës të teqesë e lë dervishin e tij më të famshëm Harabati Babanë. Për këtë arsye Teqeja e Sersem Ali Dedesë quhet edhe Teqeja e Harabati Babasë.²⁶

Të gjitha tarikatet e përhapura në Ballkan gjatë Perandorisë Osmane, e me këtë rast edhe ai bektashian, përveç aktiviteteve të tyre në rrafshin fetar ku përmes afirmimit të vlerave shpirtërore dhe morale në mënyrë të qetë dhe me tolerancë kanë arritur të depërtojnë në gjirin e popullatës vendëse, ato kanë luajtur rol të rëndësishëm edhe në rrafshin social, artistik, pedagogjik, bile edhe në atë politik.²⁷ Kështu në kompleksin e kësaj teqeje pos mesxhidit (kubbeli mejdanit) që ka shërbyer për faljen e namazeve ka ekzistuar edhe konaku kryesor ose selamllëku-haremi i pritjes së gostive dhe për bujtjen e tyre, shtëpia për ndeje verore (jaz evi), qoshku veror, shtëpia dimërore (kësh evi), konaku ose selamllëku i grave, shtëpia e imamit të faltores kryesore, objekti i furrës, objekti i hambarëve të drithit, bodrumi i quajtur “kiler”, ahuri i teqesë (at evi), çeshmeja e madhe dhe ajo e vogla, varrezat e klerikëve bektashianë, të pashajve e bejlerëve të ndryshëm, kulla e rojeve të teqesë mbi portën lindore, biblioteka etj.²⁸ Nga objektet që i ka zotëruar ky kompleks shihet qartë karakteri shumëdimensional i veprimtarisë së saj.

Gjatë historisë së saj teqeja është mbyllur e rihapur disa herë sidomos pas mbylljes së Oxhakut të Jeniçerëve më 1826 dhe për të vazhduar edhe në periudhën mes dy luftërave botërore dhe për t’u mbyllur përgjithmonë aty kah vitet 1947/48 kur kompleksi i teqesë Harabati me pronat vakëfore të saj në tërësi është uzurpuar nga pushteti i kohës duke iu shpërndarë organizatave punuese shtetërore e shoqërore që t’i disponojnë e t’i shfrytëzojnë kryesisht si lokale turistike e hotelierike.²⁹

Në vitin 1994 në konakun dimëror të teqesë fillon të banojë e të veprojë Baba Emin Tahiri i cili një kohë të gjatë ka shërbyer si mësues nëpër shkolla fillore të vendit. Sipas deklarimeve të Baba Eminit sot në Tetovë dhe rrethinë jeton një popullatë prej rreth 2000 besimtarësh që i përkasin sektit bektashian shumica prej të cilëve për shkaqe të ndryshme nuk deklarohen si të tillë dhe pjesa dërrmuese e të cilëve janë intelektualë shqiptarë. Në vitin 2000 edhe zyrtarisht arrijnë ta regjistrojnë Komunitetin Islam Bektashian në Maqedoni me qendër në Tetovë. Baba Emini ka tre dervishë nga Gostivari që herë pas here vijnë dhe prezentojnë në ligjëratat dhe zikret e Babait dhe të cilët merren me punë të ndryshme private, si bujq, zejtarë etj. Baba Emini rregullisht organizon zikre e programe të posaçme edhe për disa intelektualë vendës ku këndohen *ilahi*, *kaside* e *nefese* të cilat më pas edhe i zbërthejnë nga aspekte të ndryshme.

²⁵ Ekrem H. Ayverdi, po aty, f. 79-80.

²⁶ Nadi Bilmenoğlu, po aty, f. 50.

²⁷ Mehmet Zeki İbrahimi, “Eski Yugoslavya’da İslam Kültürünün Yerleşmesinde Tarikatların Önemi”, në revistën *İslami Araştırmalar*, v. 6, nr. 4, 1993, Ankara, f. 252-254.

²⁸ Ali Vishko, *Harabati Teqe e Tetovës dhe veprimtaria në të në periudhën e kaluar*, Tetovë, bot. Komuna e Tetovës, 1997, f. 38-40.

²⁹ Po aty, f. 51.

E. BESTYTNITË NDËR MUSLIMANËT E TETOVËS ME RRETHINË

Mitologjia e rrethit të Tetovës është e llojllojshme si në viset fushore, ashtu edhe në ato malore. Besimet popullore janë një tërësi paragjykimesh dhe përfytyrimesh që ruhen në popull. Ato kanë mbijetuar në këtë trevë duke pësuar ndryshime të vazhdueshme. Shumë elemente të fetishizmit lidhen me objekte dhe vende të kulteve të natyrës. P. sh. në disa gurë të shpuar e me zgavra kryhen disa rite të veçanta për shërim, për shëndet, për mbarësi. Ditën e Verës (14 mars) dhe Ditën e Shën Gjergjit (6 maj), nëpërmjet veprimeve magjike disa njerëz besojnë se do të gjejnë shërim, se do ta largojnë të keqen, sëmundjen, syrin e keq, shpresojnë se do t'u sigurohet shëndeti, fati për fejesë, zhvillimi normal i fëmijëve, trashëgimia e të tjerë.³⁰

Shumicën e këtyre bestytnive dhe riteve i hasim të jenë të ndërlydhura me të kremte e festa të ndryshme (kryesisht krishtere), me rastin e ndërrimit të stinëve të motmotit, me rastin e fatkeqësive të ndryshme natyrore, sëmundjeve të llojllojshme, sidomos atyre psikike etj. Këtu do të përmendim vetëm disa prej këtyre besimeve popullore që lidhen me rastet në fjalë. Kështu, natën e Krishtlindjeve (7 janar) që në popull njihet me emrin sllav “Bozhiq”, në fshatin malor Bozofcë amvisa gatuan “peta gjemsh” vetëm për djemtë beqarë. Kafshatën e parë të petës nëna e fut në gojë, pastaj e nxjerr, e mbështjell me shami dhe e vendos nën jastëk. Besohet se duke vepruar kështu, ajo do të shohë në ëndërr bashkëshorten e ardhme të djalit të vet.³¹

Në fshatin Brodec, tri ditë para dhe tri ditë pas “Bozhiqit”, femrat nuk i krehin flokët e as i presin thonjtë se “fëllejçin shkijet”. Natën e “Bozhiqit” është zakon që në vatrën e zjarrit të hidhen vezë të paziera. Nga cila anë plasat veza, andej vajza apo djali e ka fatin për fejesë.³²

Nder i veçantë i bëhet edhe Ditës së Verës (14 mars) kur nuk kryhen punë dore. Në fshatrat Gajre, Lisec dhe Shipkovicë, fillohet me ritet tri ditë para Ditës së Verës, fshehen veglat e punëdorës. Gratë e moshuara të këtyre fshatrave thonë se gjatë të kremtes nuk bën të lahen tesha se “rënejma” (vërshimi) kur bie “shej, shejnaja i merr arat”, nuk bën t'i krehësh flokët se gjatë vitit pemët nuk mbajnë fruta. Çdo shtëpi zien kokrra misri që të shtohen shpezët gjatë vitit.³³ Në rast se ndodh që natën e Ditës së Verës të mbetet në mal ndonjë kafshë shtëpiake, e zonja e shtëpisë mbledh lugët, i vë ndër saç dhe i lidh me verigën e zjarrit. Rituali përcillet me fjalët:

*“Lidhi gojën e ukit
t'bollave, t'xharpejve
me nijet t'Allahit
më m'i haje hajvont dëni send”.*³⁴

Shën Gjergji (6 maji) është kufiri kohor ndërmjet dimrit dhe verës. Emri Gjergj rrjedh nga greqishtja e vjetër, që do të thotë “bujk”. Pra, në origjinë kjo festë ka të bëjë me kultin e pjellorisë

³⁰ Edibe Selimi-Osmani, *Rite e besime popullore në viset e Tetovës dhe të Gostivarit*, Shkup, bot. Asdreni, 1996, f. 168.

³¹ Po aty, f. 27.

³² Po aty, f. 28.

³³ Po aty, f. 59.

³⁴ Po aty, f. 65.

e të prodhimitarisë bujqësore. Kjo festë njihet thuhet në të gjitha viset tona e kremtohet kudo me të njëjtat rite, vetëm emrin e ruan të krishter, ndërsa në brendësi ka të bëjë me rite të karakterit parakrishter.³⁵ Lidhur me këtë Eqrem Çabej shkruan: “Një e kremte pranverore, pas mendimit tim, është edhe Dita e Shën Gjergjit, e cila ka hyrë në të gjitha besimet shqiptare dhe kremtohet prej të gjithëve pa përjashtim”.³⁶ Çdo amvise në këtë trevë shpejton të bëjë punët e “Shinxherxhit” që të mos e gjejë kjo e kremte pa larë e pa pastruar shtëpinë. Të enjtet para Shën Gjergjit, sipas traditës, nuk krihen flokët se besohet që, sa qime flokësh bijnë në tokë, aq gjarpërinj shtohen dhe është keq. I bëhet nder festës duke mos punuar punë dore, as punë bujqësore.³⁷ “Kërcounën e madhe ruje për notën e Shinxherxhit”. Nuk bën të fiket zjarri natën e Shën Gjergjit, se është keq dhe familjes që i ndodh kjo, s’do të ketë përparim. Është keq t’i fryhet zjarrit natën e Shën Gjergjit se gjatë vitit era do t’i shkundë e do t’i thyejë pemët. Prushi në vatër natën e Shën Gjergjit nuk është mirë të derdhet me mashë, se besohet që gjatë vitit anëtarët e familjes do të grinden.³⁸

Vend të rëndësishëm zë edhe kulti i gjarpërit të cilin e hasim në forma të ndryshme. Kështu, në fshatrat Sllatinë, Dobrosht dhe Nerasht, fshatarët pohojnë se është zakon që, kur gjejnë një gjarpër të vrarë, ta hedhin në burimin e rrjedhshëm të fshatit, me besimin se ai do të sjellë shi dhe do t’i ujisë arat.

Flijimi i gjarpërit, që në mitologjinë shqiptare paraqet kultin e paraardhësve, bëhet që të sjellë plleshmëri dhe t’i mbrojë njerëzit.³⁹ Në lidhje me kultin e gjarpërit Aleksandër Stipçeviqi shkruan: “Gjarpëri ka zënë një vend pothuajse primar. Besimi në këtë kafshë htonike ishte aq i madh, saqë arriti në kult. Paraardhësit e popullit shqiptar, ilirët, me besimin që kishin ndaj tij, e konsideronin si kafshë që simbolizon të mirën dhe të keqen”.⁴⁰

Mjaft i përhapur është besimi për “bollën e shtëpisë” për të cilën mendohet se ndodhet në themelet e çdo shtëpie dhe se e ruan atë bashkë me njerëzit e saj. Në rast të mbytjes së saj, besohet në të ligat që do të pasojnë dhe në sëmundjen e rëndë psikike e fizike (ograk) të mbytësit të saj.

Besime të gabuara hasim edhe lidhur me ditët e javës. Kështu, e marta njihet si ditë e kobshme apo edhe ditë zie (me gjasë ndërlidhet me luftën e Qerbelasë), kur nuk duhet të lahen teshat, të priten thonjtë, të krihen flokët etj.

Për t’u ruajtur prej të ligave dhe prej syrit të keq, mjaft i përhapur është edhe përdorimi i ruazave të ndryshme dhe i hajmalirave. Këto kryesisht u varen foshnjave, po bile haset t’u jenë varur edhe kafshëve, vreshtave, dyqaneve etj.

Te të gjitha këto rite e bestytini të llojlojshme na bie në sy përdorimi dhe kuptimi që u jepen fjalëve si: “është keq”, “është gjynah / mëkat” etj. Koncepti “gjynah / mëkat” më tepër përdoret dhe kuptohet si një punë a sjellje që ndjell të ligat, kobin dhe mjerimin, sesa moskryerjen e një pune a sjelljeje të ndaluar apo të papëlqyer nga aspekti fetar që edhe përbën kuptimin primar të fjalës.

³⁵ Po aty, f. 104-105.

³⁶ Mark Tirta, “Kulte të bujqësisë dhe të blegtorisë në popullin tonë”, në *Etnoografia Shqiptare*, IX, Tiranë, bot. Instituti i Historisë, 1978, cituar sipas Edibe Selimi-Osmanit, po aty, f. 105.

³⁷ Edibe Selimi-Osmani, po aty.

³⁸ Po aty, f. 111.

³⁹ Po aty, f. 163.

⁴⁰ Aleksandër Stipçeviq, *Simbolet e kultit të ilirët*, Prishtinë, Rilindja, 1983, f. 57.

Këto besime dhe rite më së tepërmi vërehen te pleqtë e plakat dhe te gratë në përgjithësi, sesa te meshkujt dhe të rinjtë. Në këtë, sigurisht, ndikim të madh e të konsiderueshëm duhet të ketë pasur arsimimi i përgjithshëm dhe ai fetar si dhe vetëdijësimi i njeriut të ri për botën objektive që e rrethon. Këtu, në veçanti duhet të përmenden përpjekjet dhe kontributi i hoxhallarëve të rinj të shkolluar nëpër qendra të ndryshme të botës islame si dhe literatura islame që është në përhapje e sipër kohëve të fundit në gjuhën e popullit të cilën e flet dhe e kupton.

PËRMBYLLJE

Duke e përkufizuar fenë si një institucion të rëndësishëm shoqëror që zotëron sistemin e tij doktrinal (të besimit), atë praktik (adhurimet dhe ritualet) si dhe mundësinë për t'u organizuar në komunitete e për të krijuar grupe të mirëfillta shoqërore, u munduam që në kuadër të këtyre dimensioneve të fesë ta trajtojmë, më tepër në mënyrë deskriptive, jetën fetare në Tetovë dhe në rrethinën e saj që paraqet një krahinë të rëndësishme me karakter të theksuar fetar në Maqedoni, ku kryesisht marrin pjesë këto grupe fetare: muslimanët sunnitë dhe një pjesë bektashite, të krishterët ortodoksë, katolikë dhe protestanë, si dhe një numër i vogël ateistësh.

Në bazë të të dhënave nga studimet empirike të Kostovskit, të Pajazitit dhe të Acevskit, lirisht mund të konstatojmë se religjioziteti zë një pozitë të konsiderueshme në vetëdijen e përgjithshme, kolektive të popullatës së kësaj ane si dhe në jetën praktike të tyre. Kjo ka qenë kështu edhe në të kaluarën, pra, gjatë kohës së regjimit monist në vend, me tendencë që të rritet e të kultivohet edhe më shumë me kalimin e vendit në sistemin pluralist, pra në këtë kohë tranzicioni që është duke e përjetuar Maqedonia.

Si faktorë kryesorë që e motivojnë sjelljen fetare të muslimanëve të kësaj ane kemi konstatuar Bashkësinë Islame të Maqedonisë, gjegjësisht Myftyninë e Tetovës përmes institucioneve bazë të saj, xhamitë dhe mektebet; pastaj shoqatat e ndryshme fetare të themeluara viteve të fundit si: “Mexhlisi”, “Rumi”, “Islami dhe shkenca” si dhe Komuniteti Islam Bektashian në Maqedoni.

Përkundër këtij realiteti që mbretëron në këtë trevë, sërish akoma hasim, megjithëse në masë të ulët dhe sidomos të mosha më e vjetër, në besime e rite të kota popullore që nuk përputhen me mësimet e shëndosha të fesë Islame.

Shpresojmë të kemi dhënë një pasqyrë reale dhe të mjaftueshme për çështjen që e kemi parashtruar si lëndë punimi, duke shprehur gatishmërinë për t'i mirëpritur vërejtjet dhe sugjerimet e të tjerëve në këtë drejtim.

LITERATURA E KONSULTUAR:

- Ahmed Saim Kılavuz, *Anahatlarıyla İslam Akaidi ve Kelam'a Giriş* (Besimi islam në vija të përgjithshme dhe hyrje në shkencën e Kelamit), Stamboll, bot. Ensar Vakfi, 1987.
- Aleksandër Stipçeviq, *Simbolet e kultit te ilirët*, Prishtinë, bot. Rilindja, 1983.
- Ali Pajaziti, *Maqedonia në periudhën e tranzicionit shoqëror (1990-1997), Rinia universitare dhe religjioni /studim sociologjik/*, Logos-A, Shkup, 2003.
- Ali Vishko, *Harabati Teqe e Tetovës dhe veprimtaria në të në periudhën e kaluar*, Tetovë, bot. Komuna e Tetovës, 1997.
- Antoine Vergote, *Psychologie Religieuse* (Psikologjia e religjionit), Bruksel, bot. Charles Dessart, 1969.
- -----, *Religion, Foi, Incroyance* (Feja, besimi dhe mosbesimi), Bruksel, bot. Pierre Mardaga, 1983.
- Avzi Mustafa, *Zhvillimi i shkollës fillore shqipe në Republikën e Maqedonisë (1945-1975)*, Shkup, bot. Logos-A, 1998.
- -----, *Edukata dhe arsimi nëpër shekuj*, Shkup, bot. Shkupi, 1997.
- Behixhuddin Shehapi, *Bashkësia Islame dhe institucionet e saj*, Shkup, bot. Mexhlisi Shura i BI të Maqedonisë, 1997.
- Edibe Selimi – Osmani, *Rite e besime popullore në viset e Tetovës dhe të Gostivarit*, Shkup, bot. Asdreni, 1996.
- Ekrem H. Ayverdi, *Avrupa'da Osmanlı Mimari Eserleri, Yugoslavya* (Veprat arkitekturale osmane në Evropë, Jugosllavia), v. III, libri 3, Stamboll, 1981.
- Fauzi Skenderi, *Popullsia e Pollogut të Poshtëm (Studim demografik)*, Tetovë, 2000.
- Gordon W. Allport, *The Individual and His Religion, A Psychological Interpretation* (Individi dhe feja e tij: një interpretim psikologjik), Nju Jork-Londër, bot. Macmillan, 1960.
- Grup autorësh, *Historia e popullit shqiptar*, vëll. I, Prishtinë, 1968.
- Grup autorësh, *Tetovo i Tetovsko niz Istorijata* (Tetova dhe rrethi i Tetovës gjatë historisë), Tetovë, bot. Kuvendi i Komunës së Tetovës, 1982.
- Hayati Hökelekli, *Din Psikolojisi* (Psikologjia e fesë), Ankara, bot. Türkiye Diyanet Vakfı, 1996.
- Ilija Acevski, “Religioznosta na naselenieto vo Republika Makedonija (Religjioziteti i popullsisë në Republikën e Maqedonisë)”, në *Godishen Zbornik na Filozofskiot Fakultet na Univerzitetot vo Skopje*, libri 19 (45), 1992.
- İzzet Er, *Din Sosyolojisi* (Sociologjia e fesë), Ankara, bot. Akçağ, 1998.
- Joachim Wach, *Sociologie de la Religion* (Sociologjia e religjionit), Paris, 1995.

- Joseph Fichter, *Sosyoloji Nedir? (Ç'është sociologjia?)*, përkth. Nilgün Çelebi, Ankara, bot. Atilla, 1996.
- Mark Tirta, “Kulte të bujqësisë dhe të blegtorisë në popullin tonë”, në *Etnografia Shqiptare*, IX, Tiranë, bot. Instituti i Historisë, 1978.
- Mehmet Zeki İbrahimi, “Eski Yugoslavya’da İslam Kültürünün Yerleşmesinde Tarikatların Önemi (Rëndësia e tarikateve në përhapjen e kulturës islame në ish-Jugosllavi)”, në revistën *İslami Araştırmalar*, v. 6, nr. 4, Ankara, 1993.
- Montgomery W. Watt, *Modern Dünyada İslam Vahyi* (Shpallja islame në botën moderne), përkth. M. S. Aydın, Ankara, 1982.
- Mahmud Şeltut, *Akaid ve Şeriat* (Besimi dhe e drejta islame), vëll. I, përkth. Muharrem Tan, Stamboll, bot. Yöneliş, 1991.
- Mustafa Aydın, *Kurumlar Sosyolojisi* (Sociologjia e institucioneve), Ankara, bot. Vadi, 1997.
- Nadi Bilmenoğlu, *Kalkandelen, Dün ve Bugün* (Tetova, dje dhe sot), Stamboll, bot. privat, 1975.
- Stefan M. Kostovski, *Religijata kaj sellskoto naselenie vo Dollni Pollog* (Religjioni te popullata fshatare e Pollogut të Poshtëm), Shkup, bot. Instituti për studime sociologjike dhe politiko-juridike, 1972.
- Ünver Günay, *Din Sosyolojisi* (Sociologjia e fesë), Stamboll, bot. İnsan, 1998.
- *Zavod za statistika na Republika Makedonija, Popis na naselenieto, domačinstvata, stanovite i zemjodelskite stopanstva vo Republika Makedonija, 1994 godina* (Regjistrimi i popullsisë, amvisërive, banesave dhe ekonomive bujqësore në Republikën e Maqedonisë, viti 1994), libri XIII, Shkup, 1997.
- Zef Mirdita, “Gjashtë shekujt e parë të krishtenizmit në trevat iliro-shqiptare”, në *Krishtërimi ndër shqiptarë – Simpozium Ndërkombëtar*, Shkodër, bot. Phoenix, 2000.